

Trajnim për këshilltarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak.

Disa këshilltarë të Këshillit Bashkiak Shkodër, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me projektin Bashki të Forta, kanë marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara në muajin maj dhe qershor në Shkodër. Në këtë trajnim morën pjesë këshilltarë bashkiakë nga 5 këshillat e Qarkut Shkodër.

Trajnimet për Komisionet e Përherëshme të Këshillit të Bashkisë është organizuar në kuadër të përpjekjeve për të mbështetur njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe për të fuqizuar organet e tyre vendimmarrëse përmes rritjes së kapaciteteve të këshilltarëve vendorë, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), në bashkëpunim me Shoqatën për Autonomi Vendore (SHAV), Shkollën Shqiptare për Administratën Publike (ASPA), Shoqatën e Këshillave të Qarqeve (SHKQSH), me mbështetjen e Projektit “Bashki të Forta”(BtF2) i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Helvetas.

Qëllimi i trajnimit është fuqizimi i rolit të Komisioneve të Këshillave Bashkiake në shqyrtimin e projekt-akteve, vlerësimin e tyre dhe përgatitjen e raporteve për propozimet ndaj këshilltarëve në seancën e këshillit, me qëllim krijimin e këshillave të suksesshëm, që me rolin e tyre në mbështetje të administratave të bashkive dhe nëpërmjet angazhimit të qytetarëve të përkushtuar, do të arrijnë të përmirësojnë sa më shumë demokracinë vendore dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike.



Qershor 2024